



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 976 Prot.

Tiranë, më datë 29.10.2020

VENDIM

Nr. 358, datë 29.10.2020

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48 dhe neni 134, pika 1, dhe V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, pas shqyrtimit më parë në Këshillin Teknik të projektit, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.10.2020,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Shërbime projektimi për projektin teknik dhe marrja e lejes së ndërtimit për njësinë e banimit (pallat) me Nr. 1062, rruga “26 Nëntori”, Lagjja Nr. 7, Rajoni Nr. 2”, brënda kufirit të zonës arkeologjike “B”, me aplikues “ARKONSTUDIO” sh.p.k. dhe zhvillues Fondi Shqiptar i Zhvillimit;
2. Subjekti aplikues duhet të vijojë me procedurën ligjore për miratimin sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit;
3. Investitori duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje 3 palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të ndjekë në mënyrë periodike ditore/monitorojë kryerjen e punimeve të gërmimit për projektin e “Shërbime projektimi për projektin teknik dhe marrja e lejes së ndërtimit për njësinë e banimit (pallat) me Nr. 1062, rruga “26 Nëntori”, Lagjja Nr. 7, Rajoni Nr. 2” si dhe Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, i cili do të mbikëqyrë këtë subjekt;
4. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, nenet 144-147;
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
6. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Elva MARGARITI

SEKRETAR

Arta DOLLANI